



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 4208

NR. VENDIMI 1623

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë prej:

GJYQTARE TEUTA HOXHA

Asistuar nga sekretare gjyqësore Adela Çinari në datën 02.03.2017 mori në shqyrtim me dyer të hapura çështjen civile me Nr.4208 Akti, që iu përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËS ***, shoqëri e ***, me seli qendrore në adresen ***, përfaqësuar në gjykim me prokurë nga Av. ***.

TË PADITUR

1. Shoqëria ***, me seli në ***, përfaqësuar nga administrator z. ***, përfaqësuar në gjykim me autorizim nga Av. ***.
2. Shoqëria ***, me seli në ***, përfaqësuar në gjykim me autorizim nga Av. ***.

Objekti

Urdhërimin e masave të përkohshme ndaj subjekteve të paditur duke vendosur:

- a) ndalimin e shkeljeve që kanë filluar të kryhen ndaj markës ndërkombëtare PERONI me nr. regj. IR *** dhe markës kombëtare PERONI, me nr. regjistrimi ***;
- b) ndalimin e hyrjeve të mallrave në rrugë tregtare; c) konfiskimin dhe vënien nën kontroll, për periudhën e vazhdimin të procesit gjyqësor, objektet që përbëjnë shkeljet të të drejtave, si dhe mjetet e përdorura, kryesisht, për prodhimin e këtyre objekteve.
- c) ndalimin e veprimeve të mëtejshme që përbëjnë shkelje të të drejtave të Pronësisë Industriale që burojnë nga regjistrimi i markës ndërkombëtare PERONI me nr. regj. IR *** dhe markës kombëtare PERONI, me nr. regjistrimi ***;
- d) Heqjen dhe bllokimin e objekteve, që përbëjnë shkelje të të drejtave nga qarkullimi civil dhe shkatërrimin e këtyre objekteve;
- e) Bllokimin e mjeteve të përdorura ekskluzivisht ose pothuajse ekskluzivisht për krijimin apo prodhimin e produkteve, që përbëjnë shkelje;

f)Publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në median publike me shpenzimet e personit qe ka kryer shkeljen, sipas mënyrës së parashikuar nga Gjykata.

Baza Ligjore : Neni 31,32/a, 202 e vijues K.Pr.Civile. Nenet 638 dhe 639 K.Civil. Nenet 156,184,184/a, 184/b,185,187 te Ligjit Nr.9947 date 07.07.2008 “ Per pronesine industrial”.

Gjykata,

- si dëgjoji palën paditëse që gjatë gjykimit kërkoi miratimin e zgjidhjes me pajtim ;
- Dëgjoji palën e paditur që gjatë gjykimit kërkoi miratimin e zgjidhjes me pajtim; dhe si shqyrtoi në tërësi çështjen;

V Ë R E N

Shoqëria *** është një shoqëri e së drejtës së huaj e regjistruar në regjistrin e Shoqërive të *** dhe ushtron aktivitetet në prodhimin e pijeve alkoolike dhe joalkoolike. Ndër markat në pronësi të kësaj shoqërie e regjistruar në Regjistrin Shqiptar të Markave dhe Patentave është marka “PERONI” regjistruar me datë 18.05.1993 me numër regjistrimi *** e cila është ripërtëritëse dhe vazhdon të jetë efektive. Marka “PERONI” mbrohet për produktin “birrë” (që bën pjesë në mallrat e renditura në klasën e 32 të Klasifikimit të NICËS) klasifikimi ndërkombëtar i mallrave dhe shërbimeve, në funksion të regjistrimit të markave, vendosur sipas Marrëveshjes së Nicës datë 15 korrik 1957 dhe ratifikuar me ligjin nr.9033 datë 20.03.2003.

Nëpërmjet padisë së ngritur paditësi ka kërkuar sipas objektit të padisë duke parashtruar se është vënë në dijeni se të paditurit në bashkëpunim me njëri-tjetrin prodhojnë produktin e birrës dhe e tregtojnë këtë produkt nën shenjën“PIRONY”. Pala paditëse ka pretenduar se të paditurit birrën e prodhuar prej tyre e kanë ambalazhuar me shishet origjinale të birrës “PERONI”, me mbishkrimin e skalitur në ambalazh “Giovanni Peroni” gjë që sipas palës paditëse përbën cënim të të drejtave të mëparshme të pronësisë industriale.

Gjykata konstaton se padia e ngritur nga pala paditëse përbën një nga paditë për mbrojtjen e posaçme të të drejtave të pronësisë industriale sipas ligjit specifik Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”.

Neni 184

Procedurat kundër shkeljes së të drejtave

1. Aplikanti dhe përdoruesi i regjistruar i një treguesi gjeografik mund të ngrenë padi në gjykatë për shkeljen e të drejtave.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: Gjykatë" është Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë".

Neni 348 i K.Pr. Civile përcakton shprehimisht se: *"Mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe shërbimit, dizenjot, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale, gjykohen nga seksioni i mosmarrëveshjeve tregtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod".*

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë vlerëson se padia për shqyrtim është në kompetencën e saj lëndore dhe territoriale. Ligji i posaçëm Nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale" në disa dispozita të tij ka përcaktuar si Gjykatë kompetente për paditë që ngrihen në kuadrin e të drejtave të rregulluara nga ky ligj është pikërisht Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

Nga ana tjetër edhe Kodi i Procedurës Civile në nenin 348 të tij ka përcaktuar shprehimisht se mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe shërbimit, dizenjot, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale, gjykohen nga seksioni i mosmarrëveshjeve tregtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod.

Për rrjedhojë, bazuar në sa më lart, jo vetëm për shkak se si ligji i posaçëm "Për Pronësinë Industriale", ashtu edhe neni 348 i K.Pr Civile kanë përcaktuar si gjykatë kompetente Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, por edhe për shkak se thelbi i konfliktit konsiston në mbrojtjen e pronësisë, konkludohet se Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë është kompetente për shqyrtimin e kësaj padie.

Në seancën pregaditore dhe atë gjyqësore u paraqit pala e paditur ***, përfaqësuar nga z. *** si dhe përfaqësuesi me autorizim datë *** i palës së paditur *** Av.***.

Palët ndërgjyqëse deklaruan se kanë dakordësuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me mirëkuptim sipas akt marrëveshjes nr. ***në të cilën kanë rënë dakort brenda afateve të caktuara në marrëveshje për shkatërrimin e çdo lloj shisheje që mban emrin "Giovanni Peroni", si dhe do të tërheqin gjithë sasinë ekzistuese të birrës me emrin "PIRONY" nga tregu, të ambalazhuar me shishet "Giovanni Peroni" duke proceduar me shkatërrimin e shisheve përkatëse. Gjithashtu në marrëveshje pala e paditur angazhohet se në të ardhmen nuk do të ndërmarrë asnjë veprim që cënon të drejtat e pronësisë industriale të paditësit. Në marrëveshje përcaktohen ndër të tjera edhe kushti i ndalimit të përdorimit të etiketës "Pirony" si dhe i tapës "Peroni".

Të dy palët ndërgjyqëse kërkuan miratimin e marrëveshjes së arritur ndërmjet palëve sipas kushteve të marrëveshjes noteriale Nr. ***.

Në kushtet e mësipërme gjykata çmon se në këtë rast kushtet e marrëveshjes nuk bien në kundërshtim me ligjin dhe procedon me miratimin e zgjidhjes me pajtim të çështjes ndërmjet palëve.

PËR KËTO ARSYE

Konform neneve 126 dhe 305 e vijues të K.Pr.Civile; Gjykata;

VENDOSI

- Pranimin e kërkesës së palëve ndërgjyqëse për zgjidhjen e çështjes me pajtim sipas akt marrëveshjes Nr. ***.
- Shpenzimet gjyqësore proceduriale siç janë kryer.
- Për këtë vendim lëshohet urdhëri i ekzekutimit bashkëlidhur.
- Kundër këtij vendimi mund të behet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 ditëve afat që fillon nga e nesërmja e shpalljes.
- **U shpall në Tiranë më 02.03.2017.**

SEKRETARE
Adela Çinari

GJYQTARE
Teuta HOXHA

Shpenzime gjyqësore

Taksë regj. padie 3.000 Lekë